

1. ABSTRAKT

Narkokriminaliteti dhe veprat penale të ndërlidhura me narkotikë paraqesin një dukuri të jashtëligjshme dhe të rrezikshme mjaft të përhapur në mbarë rruzullin tokësor.

Përdorimi i narkotikëve dhe i substancave psikotrope po u sjellin mjaft dëme shoqërisë, në përgjithësi e, në veçanti, moshave të reja. Në epokën e sotme të globalizmit, me shtimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe të mallrave, narkokriminaliteti paraqet një ndër llojet më të përhapura të kriminalitetit. Ai ka prekur shoqëritë e shumë vendeve, natyrisht, edhe shoqërinë kosovare, ndaj, në mënyrë të pashmangshme, ka lindur nevoja e zhvillimit dhe e intensifikimit të luftës për parandalimin dhe luftimin e veprave penale të narkotikëve në Kosovë.

Institucionet e Kosovës kanë bërë përpjekje serioze në parandalimin dhe luftimin e grupeve të tilla duke krijuar një mekanizëm koordinues për të parandaluar dhe luftuar trafikun e drogës dhe përdorimin e paligjshëm të prekursorëve.

Përveç në nivel të institucioneve të Republikës së Kosovës, veprat penale të narkotikëve, kanë zgjuar interesim edhe tek studiuesit e hulumtuesit e ndryshëm për ti studiuar ato si dhe rolin e institucioneve në parandalimin dhe luftimin e tyre. Këto studime e hulumtime kanë qenë kryesisht të fokusuara në prezentimin e punës së prokurorive dhe gjykatave ndërsa kanë munguar studimet mbi rolin e Policisë së Kosovës në këtë drejtim. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është të analizojë masat që Policia e Kosovës ka ndërmarrë për të parandaluar dhe luftuar veprat penale të narkotikëve dhe të paraqesë karakteristikat fenomenologjike të të arrestuarve për vepra penale të narkotikëve.

Fjalë kyçe: Drogë, Policia e Kosovës, masat, parandalim, luftim, vepër penale, sanksion.